



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 322/2010**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga Muhamet Rexha, kryesues, Rafet Haxha dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën, e Suzana Novobërdaliu, Përfaqësuese Ligjore e Subjektit Politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK), që ka të bëjë me shkeljen e Rregullës Nr.11/2009 “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët”, në seancën e mbajtur me datë 06.12.2010 mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** Ankesa si e pabazuar.

## **A R S Y E T I M**

Suzana Novobërdaliu, Përfaqësuese Ligjore e Subjektit (AKR) dega në Prishtinë, ka parashtruar Ankesë kundër subjektit politik (PDK), e cila ka bërë shkeljen e Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 neni 3.1 pika (a), duke bërë Veprime të Ndaluara, në Sheshin “Nëna Tereze” me ç’rast kandidati i subjektit politik PDK Blerand Stavileci ka vendosur posterat e tij reklamues mbi posterat e kandidatit të subjektit politik AKR Ibrahim Makolli me nr. rendor 7.

Më 05 dhjetor 2010, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga Suzana Novobërdaliu, Përfaqësuese Ligjore e (AKR) dega në Prishtinë, duke pretenduar se subjekti politik PDK, ka bërë shkeljen e Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 neni 3.1 pika (a).

Parashtruesja e ankesës si provë ka përmendur fotot si dëshmi nga vendi i ngjarjes, të cilat nuk ia ka bashkangjitur ankesës.

**Rregulla dhe Procedurat e PZAP-it neni 3.6 pika c parasheh:**

*c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit;*

Duke i shqyrtuar ankesën e paraqitur nga pala ankuese, PZAP konsideron se ankesa në fjalë ka mungesë të provave të mjaftueshme dhe të pranueshme për t'u bindur se PDK ka mbuluar posterin e kandidatit të AKR-së, si dhe mos prezantimi i fotove si dëshmi mbështetëse për rastin në fjalë, nuk krijon mundësinë për të vërtetuar shkeljen e pretenduar.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

A nr. 322/2010 më datën 06.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit**

**Muhamet Rexha**

